



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 721, datë 13.12.2023

P Ë R

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.378,
DATË 5.6.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN
E RREGULLIT TEKNIK PËR PAJISJET RADIO, NJOHJEN
E NDËRSJELLË TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT TË TYRE
DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE
TË HARMONIZUARA"¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 2, e 42, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar, si dhe të pikës 3, të nenit 79, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në tekstin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara, miratuar me vendimin nr.378, datë 5.6.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja "a", e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

¹ Ky vendim është i përafuar pjesërisht me direktivën 2014/53/EU e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 16 prill 2014, mbi harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me vendosjen në treg të pajisjeve radio dhe shfuqizimin e direktivës 1999/5/EC, e ndryshuar me direktivën 2022/2380/EU e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 23 nëntor 2022

“a) pajisjet radio ndërveprojnë me aksesore të ndryshëm, përveç pajisjeve të karikimit për kategoritë ose klasat e pajisjeve radio, të specifikuara në pjesën e parë të aneksit I/1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe që referohen në mënyrë specifike në pikën 5, të këtij neni;”.

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13, me këtë përmbajtje:

“5. Pajisjet radio brenda një kategorie ose klase të specifikuar në pjesën e parë të aneksit I/1 ndërtohen në përputhje me specifikimet për aftësitë e ushqimit/ngarkimit, të përcaktuara në aneks për kategorinë ose klasën përkatëse të pajisjeve radio.

6. Për pajisjet radio që mund të ngarkohen me karikues me tel, ministri, bazuar në zhvillimet teknologjike ose të tregut dhe pas konsultimit me AKEP-in, nxjerr udhëzim për:

- a) modifikimin, shtimin ose heqjen e kategorive ose klasave të pajisjeve radio;
- b) modifikimin, shtimin ose heqjen e specifikimeve teknike, përfshirë referencat dhe përshkrimet, në lidhje me prizën e karikimit dhe protokollin e komunikimit të karikimit për çdo kategori ose klasë të pajisjeve radio në fjalë.

7. AKEP-i vlerëson vazhdimisht zhvillimet e tregut, me qëllim identifikimin e kategorive ose klasave të pajisjeve radio, të afta për t'u ngarkuar me anë të karikimit me tel dhe përfshirja në pjesën e parë të aneksit I/1 lehtëson konsumatorin dhe redukton mbetjet mjedisore.

8. AKEP-i i paraqet ministrit një raport mbi vlerësimin e kryer sipas pikës 7, të këtij neni, tre vjet pas hyrjes në fuqi të këtij rregulli dhe më pas çdo 5 vjet.

9. Për pajisjet radio, që mund të ngarkohen me mjete të ndryshme nga karikimi me tel, bazuar në zhvillimet shkencore, teknologjike dhe të tregut, ministri nxjerr udhëzim:

- a) për të prezantuar, modifikuar, shtuar, hequr kategoritë ose klasat e pajisjeve radio;
- b) për të prezantuar, modifikuar, shtuar ose hequr specifikimet teknike, përfshirë referencat dhe përshkrimet, në lidhje me ndërfaqen/et e karikimit dhe protokollin/et e komunikimit të karikimit, për çdo kategori ose klasë të pajisjeve radio në fjalë.

10. Bazuar në ligjin për standardizimin publikohet lista e standardeve të harmonizuara që përcaktojnë specifikimet teknike për ndërfaqet e karikimit dhe protokollet e komunikimit të karikimit për pajisjet radio që mund të rimbushen edhe me mjete të ndryshme nga karikimi me tel.

11. Kërkesat në lidhje me përmbajtjen e standardeve të harmonizuara të kërkuara bazohen në vlerësimin e kryer për gjendjen aktuale të teknologjive të karikimit me valë për pajisjet radio, duke mbuluar veçanërisht zhvillimet në treg, depërtimin e tyre në treg, fragmentimin e tregut, performancën teknologjike, ndërveprueshmërinë, efikasitetin e energjisë dhe performancën e karikimit.

12. Në përgatitjen e udhëzimeve të përmendura në këtë nen në lidhje me pajisjet radio që mund të karikohen me anë të karikimit me tel, si dhe në lidhje me pajisjet radio që mund të karikohen me mjete të ndryshme nga karikimi me tel merret parasysh shkalla e pranimit në treg të specifikimeve teknike në shqyrtim, lehtësitë për konsumatorin, shkalla e reduktimit të mbetjeve mjedisore dhe fragmentimi i tregut që mund të pritët nga këto specifikime teknike.

13. Specifikimet teknike që bazohen në standardet shqiptare (SSH) dhe/ose evropiane ose ndërkombëtare përkatëse të disponueshme konsiderohen se përmbushin objektivat e përcaktuar në pikën 12, të këtij neni. Kur këto standarde nuk ekzistojnë ose kur AKEP-i, bazuar në vlerësimin e tij teknik përcakton se ato nuk i përmbushin objektivat në mënyrë optimale, mund të përcaktohen specifikime të tjera teknike që përmbushin më mirë këta objektiva.”.

Neni 2

Pas nenit 3 shtohet neni 3/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Pajisjet radio pa pajisje karikimi

1. Kur një operator ekonomik u ofron konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë fundorë mundësinë për të blerë pajisje radio, të përcaktuara në pikën 5, të nenit 3, të këtij rregulli, së bashku me një pajisje karikimi, operatori ekonomik i ofron, gjithashtu konsumatorit dhe përdoruesve të tjerë fundorë mundësinë e marrjes së asaj pajisjeje radio pa pajisje karikimi.

2. Operatorët ekonomikë duhet të sigurojnë informacion nëse pajisja e karikimit përfshihet apo jo në pajisjen radio të përmendur në pikën 5, të nenit 3, të këtij rregulli.
3. Informacioni sipas pikës 2 të këtij neni duhet të jepet në një formë grafike, duke përdorur një piktogram të përshtatshëm për përdoruesit dhe lehtësisht të aksesueshëm, siç përcaktohet në pjesën e tretë të aneksit I/1 të këtij rregulli teknik.
4. Kur një pajisje radio vihet në dispozicion të konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë fundorë, piktogrami duhet të printohet në paketim ose të ngjitet në paketim. Piktogrami duhet të shfaqet në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme dhe, në rastin e shitjes në largësi, të shfaqet afër treguesit të çmimit.
5. Si pasojë e ndryshimeve në pjesën e parë dhe të dytë të aneksit I/1, sipas përcaktimeve në nenin 3, të këtij rregulli, ose për shkak të ndryshimeve në kërkesat e etiketimit apo të progresit teknologjik, elementet grafike ose tekstuale të piktogramës mund të modifikohen përkatësisht në pjesën përkatëse të aneksit I/1.”.

Neni 3

Pas pikës 9, të nenit 10, shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Në rastin e pajisjeve radio të përmendura në pikën 5, të nenit 3, të këtij rregulli, udhëzimet përmbajnë informacion për specifikimet për aftësitë e karikimit të pajisjeve radio dhe pajisjet karikuese të përshtatshme, siç përcaktohet në pjesën e dytë të aneksit I/1. Përveç informacionit të përfshirë në udhëzime, informacioni do të shfaqet në një etiketë, sipas modelit të përcaktuar në pjesën e katërt të aneksit I/1. Etiketa duhet të printohet në udhëzime dhe në paketim ose të ngjitet në paketim. Në mungesë të paketimit, etiketa duhet të fiksohet me ngjitës te pajisja radio. Etiketa duhet të shfaqet në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme dhe në rastin e shitjes në largësi, afër treguesit të çmimit. Kur madhësia ose natyra e pajisjes radio nuk e lejon ndryshe, etiketa mund të printohet si një dokument i veçantë që shoqëron pajisjen radio. Për reflektimin e ndryshimeve të miratuara në pjesën e parë dhe të dytë të aneksit I/1, sipas përcaktimeve në nenin 3, të këtij rregulli, ose kur diktohet nga ndryshimet e kërkesave të etiketimit apo për shkak të progresit teknologjik, elementet grafike ose tekstuale të pjesës së katërt të aneksit I/1 do të modifikohen përkatësisht, duke futur, modifikuar, shtuar ose hequr çdo detaj në lidhje me informacionin, elementet grafike ose tekstuale, siç përcaktohet në këtë nen.”.

Neni 4

Pas pikës 4, të nenit 12, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4.1 Kur pajisjet radio të përmendura në pikën 5, të nenit 3, të këtij rregulli, vihen në dispozicion të konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë fundorë, importuesi duhet të sigurojë që:

- a) këto pajisje radio të kenë ose të pajisen me një etiketë në përputhje me pikën 9.1, të nenit 10, të këtij rregulli;
- b) etiketa të jetë shfaqur në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme dhe, në rastin e shitjes në largësi, të jetë vendosur afër treguesit të çmimit.”.

Neni 5

Pas pikës 2, të nenit 13, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Kur pajisjet radio të përmendura në pikën 5, të nenit 3, të këtij rregulli, i vihen në dispozicion konsumatorëve dhe përdoruesve të tjerë fundorë, shpërndarësit duhet të sigurojnë që:

- a) pajisjet radio të kenë ose të pajisen me një etiketë, në përputhje me pikën 9/1, të nenit 10, të këtij rregulli;
- b) etiketa të jetë shfaqur në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme dhe, në rastin e shitjes në largësi, të jetë vendosur afër treguesit të çmimit.”.

Neni 6

Në pikën 1, të nenit 17, fjalët “... sipas përcaktimeve të nenit 3.” zëvendësohen me “... sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 5 të nenit 3”.

Neni 7

Në pikën 3, të nenit 21, fjalët “... do të jetë në gjuhën shqipe.” zëvendësohen me “... do të jetë në gjuhën zyrtare të vendit ku organi i miratuar/notifikuar është krijuar ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga organi i miratuar/notifikuar”.

Neni 8

Në nenin 35 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli ndryshohet dhe zëvendësohet me “Procedura në nivel kombëtar për trajtimin e pajisjeve radio që paraqesin rrezik ose nuk janë në përputhje me kërkesat thelbësore”.
2. Në pikën 1, pas fjalëve “... për aspektet e mbrojtjes së interesit publik, ...” shtohen “... ose që nuk përputhen me të paktën një nga kërkesat thelbësore të zbatueshme siç përcaktohet në nenin 3,...”.

Neni 9

Në pikën 1, të nenit 38, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronjat “ë” dhe “g”, ndryshohen, si më poshtë vijon:
 - “ë) mungesës, si pjesë shoqëruese e pajisjes radio, të informacionit sipas pikës 9/1, të nenit 10, të këtij rregulli, deklaratës EC të konformitetit ose të kufizimeve të përdorimit sipas përcaktimeve në pikën 11, të nenit 10, të këtij rregulli;
 - g) moszbatimit të përcaktimeve të pikës 1, të nenit 3/1 ose nenit 5.”.
2. Pas shkronjës “g” shtohen shkronjat “h”, “i”, dhe “j”, me këtë përmbajtje:
 - “h) piktogrami i përmendur në pikën 3, të nenit 3/1, ose etiketa siç referohet në pikën 9/1, të nenit 10, të këtij rregulli, nuk është hartuar saktë;
 - i) etiketa e përmendur në pikën 9.1, të nenit 10, të këtij rregulli, nuk shoqëron pajisjet radio në fjalë;
 - j) piktogrami ose etiketa nuk është ngjitur ose shfaqur në përputhje me pikën 3, të nenit 3/1, ose me pikën 9.1, të nenit 10, të këtij rregulli, përkatësisht.”.

Neni 10

Pas nenit 38 shtohet neni 39, me këtë përmbajtje:

“Neni 39

Dispozitë kalimtare

1. Masat e parashikuara për kategoritë ose klasat e pajisjeve radio, të përcaktuara në pikat 1.1 deri në 1.12, të pjesës së parë të aneksit I/1, zbatohen duke filluar nga data 1 janar 2025.
2. Masat e parashikuara për kategoritë ose klasat e pajisjeve radio, të përcaktuara në pikën 1.13, të pjesës së parë, të aneksit I/1, zbatohen duke filluar nga data 1 korrik 2026.”.

Neni 11

Pas aneksit I, bashkëlidhur rregullit, shtohet aneksi I/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 12

Aneksi VIII, bashkëlidhur rregullit, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

ANEKSI I/1
SPECIFIKIMET DHE INFORMACIONET NË LIDHJE ME
KARIKUESIT TË ZBATUESHME PËR DISA KATEGORI OSE KLASA
TË PAJISJEVE RADIO

PJESA I
Specifikimet në lidhje me aftësitë e karikimit

1. Kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të kësaj pjese zbatohen për kategoritë ose klasat e mëposhtme të pajisjeve radio:
 - 1.1. telefonat celularë;
 - 1.2. tabletat;
 - 1.3. kamerat digjitale;
 - 1.4. kufjet;
 - 1.5. kufje me mikrofon;
 - 1.6. konsolat e videoljërave me dorë;
 - 1.7. altoparlantët portativë;
 - 1.8. lexuesit elektronikë;
 - 1.9. tastierat;
 - 1.10. mouset
 - 1.11. sistemet portative të navigimit;
 - 1.12. kufje pa tel;
 - 1.13. laptopët.
2. Për aq sa janë në gjendje të ngarkohen me anë të karikuesit me tel, kategoritë ose klasat e pajisjeve radio, të përmendura në pikën 1, të kësaj pjese,:
 - 2.1. do të jenë të pajisur me prizën USB Tipi-C, siç përshkruhet në specifikimet teknike të standardit SSH EN IEC 62680-1-3:2022 “Ndërfaqet universale të autobusëve serialë për të dhënat dhe energjinë – Pjesa 1-3: Komponentët e zakonshëm – specifikimet e Kabllit dhe Lidhësit, USB ModelType-C®”, dhe ajo e marrjes që priza, të mbetet e aksesueshme dhe funksionale gjatë gjithë kohës;
 - 2.2. do të jenë në gjendje të ngarkohen me kablllo që përputhen me specifikimet teknike të standardit SSH EN IEC 62680-1-3:2022 “Ndërfaqet universale të autobusëve serialë për të dhënat dhe energjinë - Pjesa 1-3: Komponentët e zakonshëm - Specifikimi i kablllove dhe lidhësit USB TypeModel-C®”.
3. Për aq sa janë në gjendje të ngarkohen me anë të karikuesit me tel me tension më të lartë se 5V, me rrymë më të lartë se 3A ose fuqi më të larta se 15Ë, kategoritë ose klasat e pajisjeve radio të përmendura në pikën 1 të kësaj pjese:

3.1. do të inkorporojnë shpërndarjen e energjisë USB, përfshijnë fuqinë e furnizuar USB, siç përshkruhet në specifikimet teknike të standardit SSH EN IEC 62680-1-2:2022 "Ndërfaqet universale të autobusëve serialë për të dhënat dhe energji fuqinë- Pjesa 1-2: Komponentët e zakonshëm - Specifikimi i shpërndarjes së energjisë fuqisë së furnizuar USB";

3.2. do të sigurojnë që çdo protokoll shtesë karikimi të mundësojë funksionalitetin e plotë të fuqisë së furnizuar shpërndarjes së energjisë USB, të përmendur në pikën 3.1, pavarësisht nga pajisja e karikimit të përdorur.

PJESA II

Informacion mbi specifikimet për aftësitë e karikimit dhe pajisjet e përshtatshme të karikimit

Në rastin e pajisjeve radio që përfshihen në objektin e pikës 5, të nenit 3, informacioni i mëposhtëm do të tregohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 9.1 të nenit 10, dhe mund të vihet në dispozicion si shtesë përveç kësaj, me anë të kodeve QR ose me zgjidhje të ngjashme elektronike:


- a) në rastin e të gjitha kategorive ose klasave të pajisjeve radio, që i nënshtrohen kërkesave të përcaktuara në pjesën I, një përshkrim të kërkesave për energjitë e pajisjeve të karikimit me tel, që mund të përdoren me atë pajisje radio, duke përfshirë fuqinë minimale të nevojshme për të karikuar pajisjet e radios dhe fuqinë maksimale të nevojshme për të karikuar pajisjet e radios me shpejtësinë maksimale të karikimit të shprehur në Ęat, duke shfaqur tekstin: "Fuqia e dhënë ofruar nga karikuesi duhet të jetë midis min [x] Ęat që kërkohet nga pajisja e radios, dhe max [y] Ęat, në mënyrë që të arrihet shpejtësia maksimale e karikimit". Numri i Ęat duhet të shprehë, përkatësisht, fuqinë minimale të kërkuar nga pajisja radio dhe fuqinë maksimale të kërkuar nga pajisja radio për të arritur shpejtësinë maksimale të karikimit;
- b) në rastin e pajisjeve radio që i nënshtrohen kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të pjesës I, një përshkrim të specifikimeve në lidhje me aftësitë e karikimit të pajisjes radio, për aq sa është në gjendje të rikarikohet me mjetet e karikimit me tel në tensione më të larta se 5V, ose rryma më të larta se 3A, ose fuqi më të larta se 15Ę, duke përfshirë një tregues që pajisja radio mbështet protokollin e karikimit të shpërndarjes së energjisë së furnizuar USB, duke shfaqur tekstin "karikim i shpejtë USB PD (fuqia e furnizuar)" dhe një tregues të çdo protokollit tjetër karikimi të suportuar, duke shfaqur emrin e tij në format teksti.

PJESA III


Piktograma që tregon nëse një pajisje karikuese është ose jo e përfshirë me pajisjen radio

1. Piktograma duhet të jetë në formatet e mëposhtme:

1.1. Nëse me pajisjen radio përfshihet një pajisje karikimi, është e përfshirë me pajisjen radio:



1.2. Nëse me pajisjen radio nuk përfshihet asnjë pajisje karikimi është e përfshirë me pajisjen radio:




2. Piktograma mund të ndryshojë në pamje (p.sh. përsa i përket ngjyrës, fortësisë ose zbrazësisë, trashësisë së vijës), me kusht që të mbetet e dukshme dhe e lexueshme. Nëse piktograma zvogëlohet ose zmadhohet, do të ruhen përmasat e përcaktuara në vizatimet në pikën 1 të kësaj pjese. Dimensioni “a” i përmendur në pikën 1 të kësaj pjese do të jetë më i madh ose i barabartë me 7 mm, pavarësisht nga ndryshimi.

PJESA IV

Përmbajtja dhe formati i etiketës

1. Etiketa/emërtimi duhet të ketë formatin e mëposhtëm :



2. Shkronjat "XX" do të zëvendësohen nga figura që korrespondon me fuqinë minimale të kërkuar nga pajisja e radios për të karikuar, e cila përcakton fuqinë minimale që duhet të furnizojë një pajisje karikuese për të karikuar pajisjen radio. Shkronjat "YY" do të zëvendësohen nga figura që korrespondon me fuqinë maksimale të kërkuar nga pajisja radio për të arritur shpejtësinë maksimale të karikimit, e cila përcakton fuqinë që duhet të furnizojë një pajisje karikuese të paktën për të arritur atë shpejtësi maksimale të karikimit. Shkurtesa "USB PD" (Shpërndarja e energjisë/Fuqia e furnizuar USB) do të shfaqet nëse pajisja radio e mbështet atë protokoll komunikimi karikimi. "USB PD" është një protokoll që negocion zhvillon/ofron shpërndarjen më të shpejtë të rrymës nga pajisja e karikimit në pajisjen radio, pa shkurtuar jetëgjatësinë e baterisë.
3. Etiketa/Emërtimi mund të ndryshojë në pamje (p.sh. për sa i përket ngjyrës, e fortësisë ose zbrazëtisë, trashësisë së vijës), me kusht që të mbetet e dukshme dhe e lexueshme. Nëse etiketa/emërtimi zvogëlohet ose zmadhohet, do të ruhen përmasat e përcaktuara në vizatimin në pikën 1 të kësaj pjese. Dimensioni "a" i përmendur në pikën 1 të kësaj pjese do të jetë më i madh ose i barabartë me 7 mm, pavarësisht nga ndryshimet.”.

ANEKSI VIII

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

| Nr. | Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar (dhe dokumenti i referencës) | Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar në shqip | Viti i adoptimit si SSH | Mënyra e adoptimit (me fage të pare FP ose me përkthim të plotë PP) |
|-----|---|---|-------------------------|---|
| | EN 50360:2017 Product standard to demonstrate the compliance of ÷ireless communication devices, ëith the basic restrictions and exposure limit values related to human exposure to electromagnetic fields in the frequency range from 300 MHz to 6 GHz: devices used next to the ear | SSH EN 50360:2017 Standard produkti për të demonstruar përputhjen e pajisjeve të komunikimit pa tel me kufizimet bazë dhe vlerat limit të ekspozimit në lidhje me ekspozimin e njeriut ndaj fushave elektromagnetike në diapazonin e frekuencave nga 300 MHz deri në 6 GHz: pajisjet e përdorura ngjitur me veshin | 2018 | FP |
| | EN 50385:2017 Product standard to demonstrate the compliance of base station equipment ëith radiofrequency electromagnetic field exposure limits (110 MHz - 100 GHz), ëhen placed on the market | SSH EN 50385:2017 Standard produkti për të vërtetuar përputhshmërinë e pajisjeve të stacionit bazë me limitet e ekspozimit ndaj fushës elektromagnetike të frekuencave të radios (110 MHz - 100 GHz), kur vendosen në treg | 2018 | FP |
| | EN 50401:2017 Product standard to demonstrate the compliance of base station equipment ëith radiofrequency electromagnetic | SSH EN 50401:2017 Standard produkti për të vërtetuar përputhshmërinë e pajisjeve të stacionit bazë me limitet e ekspozimit ndaj fushës | 2018 | FP |

| | | | | |
|--|---|---|------|----|
| | field exposure limits (110 MHz - 100 GHz), ëhen put into service | elektromagnetike të frekuencave të radios (110 MHz - 100 GHz), kur vendosen në shërbim | | |
| | EN 50566:2017:2017 Product standard to demonstrate the compliance of ëireless communication devices ëith the basic restrictions and exposure limit values related to human exposure to electromagnetic fields in the frequency range from 30 MHz to 6 GHz: hand-held and body mounted devices in close proximity to the human body | SSH EN 50566:2017 Standard produkti për të demonstruar përputhshmërinë e pajisjeve të komunikimit pa tel me kufizimet bazë dhe vlerat limit të ekspozimit lidhur me ekspozimin e njeriut ndaj fushave elektromagnetike në gamën e frekuencave nga 30 MHz deri 6 GHz: pajisjet që mbahen në dorë dhe të montuara në trup shumë afër trupit të njeriut | 2018 | FP |
| | EN 55035: EN 55035:2017/A11:2020 Electromagnetic compatibility of multimedia equipment - Immunity requirements CISPR 35:2016 (Modified) | SSH EN 55035:2017/A11:2020 Përputhshmëria elektromagnetike për pajisjet multimediale - Kërkesat për imunitetin | 2021 | FP |
| | EN 300 065 V2.1.2:2016 Narroë-band direct-printing telegraph equipment for receiving meteorological or navigational information (NAVTEX); Harmonised Standard covering the essential requirements of articles 3.2 and 3.3(g) of the Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 065 V2.1.2:2016 Pajisjet e telegrafit me bandë të ngushtë dhe printim të drejtpërdrejtë për marrjen e informacioneve meteorologjike ose të lundrimit (NAVTEX); Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 dhe 3.3(g) të Direktivës 2014/53/E | 2017 | FP |
| | EN 300 086 V2.1.2:2016 Land Mobile Service; Radio equipment ëith an internal or external RF connector intended primarily for analogue speech; Harmonised Standard covering the essential requirements of | SSH EN 300 086 V2.1.2:2016 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje radio me një lidhës RF të brendshëm ose të jashtëm të destinuar kryesisht për komunikim analog; Standard i harmonizuar që mbulon | 2017 | FP |

| | | | | |
|--|---|---|------|----|
| | article 3.2 of the Directive 2014/53/EU | kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU | | |
| | EN 300 113 V2.2.1:2016 Land Mobile Service; Radio equipment intended for the transmission of data (and/or speech) using constant or non-constant envelope modulation and having an antenna connector; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 113 V2.2.1:2016 Shërbimi tokësor i lëvizshëm; Pajisje radio të destinuara për transmetimin e të dhënave (dhe/ose të të folurit) që përdorin një modulim me mbulim konstant ose jo-konstant dhe që kanë një bashkues për antenë; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU | 2021 | FP |
| | EN 300 219 V2.1.1:2016 Land Mobile Service; Radio equipment transmitting signals to initiate a specific response in the receiver; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 219 V2.1.1:2016 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje radio që transmetojnë sinjale për të iniciuar një përgjigje specifike tek marrësi; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU | 2017 | FP |
| | EN 300 220-2 V3.1.1:2017 Short Range Devices (SRD) operating in the frequency range 25 MHz to 1 000 MHz; Part 2: Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU for non specific radio equipment | SSH EN 300 220-2 V3.1.1:2017 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD) që punojnë në diapazonin e frekuencave nga 25 MHz deri në 1 000 MHz; Pjesa 2: Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU për pajisjet radio jo-specifike | 2018 | FP |

| | | | | |
|--|---|--|------|----|
| | <p>EN 300 220-3-1 V2.1.1:2016 Short Range Devices (SRD) operating in the frequency range 25 MHz to 1 000 MHz; Part 3-1: Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU; Loë duty cycle high reliability equipment, social alarms equipment operating on designated frequencies (869,200 MHz to 869,250 MHz)</p> | <p>SSH EN 300 220-3-1 V2.1.1:2016 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD) që punojnë në diapazonin e frekuencave nga 25 MHz deri në 1 000 MHz; Pjesa 3-1: Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU; Cikël i ulët pune për pajisje të besueshmërisë së lartë, alarme sociale dhe pajisjet që punojnë në frekuenca të caktuara (869.200 MHz për 869.250 MHz)</p> | 2017 | FP |
| | <p>EN 300 220-3-2 V1.1.1:2017 Short Range Devices (SRD) operating in the frequency range 25 MHz to 1 000 MHz; Part 3-2: Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU; Ëireless alarms operating in designated LDC/HR frequency bands 868,60 MHz to 868,70 MHz, 869,25 MHz to 869,40 MHz, 869,65 MHz to 869,70 MHz</p> | <p>SSH EN 300 220-3-2 V1.1.1:2017 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD) që punojnë në diapazonin e frekuencave nga 25 MHz deri në 1 000 MHz; Pjesa 3-2: Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU; Alarmet pa kabëll (Ëireless) që punojnë në bandat e frekuencave të përcaktuara LDC/HR 868,60 MHz në 868,70 MHz, 869,25 MHz në 869,40 MHz, 869,65 MHz në 869,70 MHz</p> | 2017 | FP |
| | <p>EN 300 220-4 V1.1.1:2017 Short Range Devices (SRD) operating in the frequency range 25 MHz to 1 000 MHz; Part 4: Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU;</p> | <p>SSH EN 300 220-4 V1.1.1:2017 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD) që punojnë në diapazonin e frekuencave nga 25 MHz deri në 1 000 MHz; Pjesa 4: Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore</p> | 2017 | FP |

| | | | | |
|--|--|---|------|----|
| | Metering devices operating in designated band 169,400 MHz to 169,475 MHz | të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU; Pajisjet e matjes që punojnë në bandë të përcaktuara 169,400 MHz në 169,475 MHz | | |
| | EN 300 224 V2.1.1:2017 Land Mobile Service; Radio Equipment for use in a Paging Service operating within the frequency range 25 MHz - 470 MHz; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 224 V2.1.1:2017 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje Radio për përdorim në një Shërbim Faqosje që punojnë brenda diapazonit të frekuencave 25 MHz - 470 MHz; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU | 2018 | FP |
| | EN 300 296 V2.1.1:2016 Land Mobile Service; Radio equipment using integral antennas intended primarily for analogue speech; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 296 V2.1.1:2016 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje radio që përdorin antena integrale të destinuara kryesisht për komunikim analog; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53EU | 2016 | FP |
| | EN 300 328 V2.2.2:2019 Ëideband transmission systems; Data transmission equipment operating in the 2,4 GHz band; Harmonised Standard for access to radio spectrum | SSH EN 300 328 V2.2.2:2019 Sistemet e transmetimit me bandë të gjerë; Pajisje të transmetimit të të dhënave që punojnë në bandën 2,4 GHz; Standard i harmonizuar për aksesin në spektrin e radios | 2020 | FP |
| | EN 300 330 V2.1.1:2017 Short Range Devices (SRD); Radio equipment in the frequency range 9 kHz to 25 MHz and inductive loop systems in the frequency range 9 kHz to 30 MHz; Harmonised | SSH EN 300 330 V2.1.1:2017 Pajisje me Rreze të Shkurtër (SRD); Pajisje radio në diapazonin e frekuencave 9 kHz deri në 25 MHz dhe sistemet e cikleve induktive në diapazonin e frekuencave 9 | 2017 | FP |

| | | | | |
|--|---|---|------|----|
| | Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU | kHz deri në 30 MHz; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU | | |
| | EN 300 341 V2.1.1:2016 Land Mobile Service; Radio equipment using an integral antenna transmitting signals to initiate a specific response in the receiver; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 341 V2.1.1:2016 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje radio që përdorin një antenë integrale që transmeton sinjale për të nxitur një përgjigje specifike tek marrësi; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53EU | 2016 | FP |
| | EN 300 390 V2.1.1:2016 Land Mobile Service; Radio equipment intended for the transmission of data (and speech) and using an integral antenna; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 390 V2.1.1:2016 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisjet radio të destinuara për transmetimin e të dhënave (dhe të të folurit) dhe që përdorin një antenë integrale; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53EU | 2016 | FP |
| | EN 300 422-1 V2.1.2 Wireless Microphones; Audio PMSE up to 3 GHz; Part 1: Class A Receivers; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 422-1 V2.1.2:2017 Mikrofonat pa kabëll (ëireless); Audio PMSE mbi deri në 3 GHz; Pjesa 1: Marrës i Klasës A; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU SSH EN 300 422-1 V2.2.1:2021 Mikrofonat pa kabëll (ëireless); Audio PMSE mbi deri në 3 GHz; Pjesa 1: Pajisje audio PMSE mbi deri në 3 GHz; Standard i harmonizuar për aksesin në spektrin e radios | 2023 | FP |

| | | | | |
|--|---|--|------|----|
| | EN 300 422-1 V2.2.1:2021 Ëireless Microphones; Audio PMSE up to 3 GHz; Part 1: Audio PMSE Equipment up to 3 GHz; Harmonised Standard for access to radio spectrum | SSH EN 300 422-1 V2.2.1:2021 Mikrofonat pa kabëll (ëireless); Audio PMSE mbi deri në 3 GHz; Pjesa 1: Pajisje audio PMSE mbi deri në 3 GHz; Standard i harmonizuar për aksesin në spektrin e radios | 2023 | FP |
| | EN 300 422-4 V2.1.1:2017 Ëireless Microphones; Audio PMSE up to 3 GHz; Part 4: Assistive Listening Devices including personal sound amplifiers and inductive systems up to 3 GHz; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 422-4 V2.1.1:2017 Mikrofona pa kabëll (ëireless); Audio PMSE mbi deri në 3 GHz; Pjesa 4: Pajisje Dëgjimi Ndhmëse duke përfshirë amplifikatorët personal të zërit dhe sistemet induktive deri në 3 GHz; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU | 2017 | FP |
| | EN 300 433 V2.1.1:2016 Citizens' Band (CB) radio equipment; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 433 V2.1.1:2016 Pajisje radio për Bandën e Qytetarëve (CB); Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU | 2016 | FP |
| | EN 300 440 V2.1.1:2017 Short Range Devices (SRD); Radio equipment to be used in the 1 GHz to 40 GHz frequency range; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 440 V2.1.1:2017 Pajisjet me Rreze të Shkurtër (SRD); Pajisje radio për tu përdorur në diapazonin e frekuencave nga 1 GHz në 40 GHz; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU | 2019 | FP |

Ky standard i harmonizuar nuk i adresohet, për marrësit e kategorive 2 dhe 3 siç përcaktohet në tabelën 5, kërkesave lidhur me parametrat e performancës së marrësit dhe nuk jep presumimin e konformitetit për këto parametra.

| | | | | |
|---|--|---|-------------|-----------|
| | <p>EN 300 454-2 V1.1.1:2000 Electromagnetic compatibility and Radio spectrum Matters (ERM); Eide band audio links; Part 2: Harmonized EN under article 3.2 of the R&TTE Directive</p> | <p>SSH EN 300 454-2 V1.1.1:2000 Çështjet e pajtueshmërisë Elektromagnetike dhe të spektrit të Radios (ERM); Lidhjet audio me brez të gjerë; Pjesa 2: EN i harmonizuar sipas artikullit 3.2 të direktivës R&TTE</p> | <p>2017</p> | <p>FP</p> |
| <p>Ky standard i harmonizuar nuk i adresohet kërkesave lidhur me parametrat e performancës së marrësit dhe nuk jep presumimin e konformitetit për këto parametra.</p> | | | | |
| | <p>EN 300 487 V2.1.2:2016 Satellite Earth Stations and Systems (SES); Harmonised Standard for Receive-Only Mobile Earth Stations (ROMES) providing data communications operating in the 1,5 GHz frequency band; Radio Frequency (RF) specifications covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU</p> | <p>SSH EN 300 487 V2.1.2:2016 Sistemet dhe Stacionet Satelitore në Tokë (SES); Standard i harmonizuar për Stacionet Tokësore të Lëvizshëm Vetëm Marrës (ROMES) që ofrojnë komunikim të dhënash që punojnë në bandën e frekuencave 1,5 GHz; Specifikimet e Radio Frekuencës (RF) që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU</p> | <p>2017</p> | <p>FP</p> |
| | <p>EN 300 674-2-1 V3.1.1:2022 Transport and Traffic Telematics (TTT); Dedicated Short Range Communication (DSRC) transmission equipment (500 kbit/s / 250 kbit/s) operating in the 5 795 MHz to 5 815 MHz frequency band; Part 2: Harmonised Standard for access to radio spectrum; Sub-part 1: Road Side Units (RSU)</p> | <p>SSH EN 300 674-2-1 V3.1.1:2022 Telematikat e Trafikut dhe Transportit (TTT); Pajisje transmetimi për Komunikimin e Dedicuar me Largësi të Shkurtra (DSRC), (500 kbit/s/250 kbit/s), që punojnë në bandën e frekuencave 5 795 MHz në 5 815 MHz; Pjesa 2: Standard i harmonizuar për aksesin në spektrin e radios; Nën-pjesa 1: Njësitë në Anë të Rrugës (RSU)</p> | <p>2022</p> | <p>FP</p> |

| | | | | |
|--|---|---|------|----|
| | <p>EN 300 674-2-2 V2.2.1:2019 Transport and Traffic Telematics (TTT); Dedicated Short Range Communication (DSRC) transmission equipment (500 kbit/s / 250 kbit/s) operating in the 5 795 MHz to 5 815 MHz frequency band; Part 2: Harmonised Standard for access to radio spectrum; Sub-part 2: On-Board Units (OBU)</p> | <p>SSH EN 300 674-2-2 V2.2.1:2019 Telematikat e Trafikut dhe Transportit (TTT); Pajisje transmetimi për Komunikimin e Dedikuar me Largësi të Shkurtra (DSRC), (500 kbit/s / 250 kbit/s), që punojnë në bandën e frekuencave 5 795 MHz në 5 815 MHz; Pjesa 2: Standard i harmonizuar për aksesin në spektrin e radios; Nën-pjesa 2: Njësitë Në Bord (OBU)</p> | 2020 | FP |
| | <p>EN 300 676-2 V2.1.1:2016 EN 300 676-2 V2.1.1:2015 Ground-based VHF hand-held, mobile and fixed radio transmitters, receivers and transceivers for the VHF aeronautical mobile service using amplitude modulation; Part 2: Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU</p> | <p>SSH EN 300 676-2 V2.1.1:2016 Radio transmetuesit, marrësit dhe marrës/dhënës VHF të lëvizshme dhe të fiksuar, me bazë në tokë që mbahen në dorë, për shërbimin aeronautikë VHF të lëvizshme që përdor modulimin e amplitudës; Pjesa 2: Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU</p> | 2017 | FP |
| | <p>EN 300 698 V2.3.1:2018 Radio telephone transmitters and receivers for the maritime mobile service operating in the VHF bands used on inland äateräays; Harmonised Standard for access to radio spectrum and for features for emergency services</p> | <p>SSH EN 300 698 V2.3.1:2018 Transmetues dhe marrës radiotelefonik për shërbimit detar të lëvizshëm që punojnë në bandat VHF që përdoren në lundrimin në rrugët ujore në tokë; Standard i harmonizuar për aksesin në spektrin e radios dhe për karakteristikat për shërbimet e emergjencës</p> | 2020 | FP |
| | <p>EN 300 718-1 V2.2.1:2021</p> | <p>SSH EN 300 718-1 V2.2.1:2021</p> | 2021 | FP |

| | | | | |
|--|--|--|------|----|
| | Avalanche Beacons operating at 457 kHz; Transmitter-receiver systems; Part 1: Harmonised Standard for access to radio spectrum | Sinjalizuesit e Ortekëve që punojnë në 457 kHz; Sistemet transmetuese-marrëse; Pjesa 1: Standard i harmonizuar për aksesin në spektrin e radios | | |
| | EN 300 718-2 V1.1.1:2001 Electromagnetic compatibility and Radio spectrum Matters (ERM); Avalanche Beacons; Transmitter-receiver systems; Part 2: Harmonized EN covering essential requirements of article 3.2 of the R&TTE Directive | SSH EN 300 718-2 V1.1.1:2001 Çështjet e pajtueshmërisë Elektromagnetike dhe të spektrit të Radios (ERM); Sinjalizueset e Orteqeve; Sistemet transmetuese-marrëse; Pjesa 2: EN i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të direktivës R&TTE | 2017 | FP |
| Ky standard i harmonizuar nuk i adresohet kërkesave lidhur me parametrat e performancës së marrësit dhe nuk jep presumimin e konformitetit për këto parametra. | | | | |
| | EN 300 718-2 V2.1.1:2018 Avalanche Beacons operating at 457 kHz; Transmitter-receiver systems; Part 2: Harmonised Standard for features for emergency services | SSH EN 300 718-2 V2.1.1:2018 Sinjalizuesit e Ortekëve që punojnë në 457 kHz; Sistemet transmetuese-marrëse; Pjesa 2: Standard i harmonizuar për karakteristikat për shërbimet e emergjencës | 2018 | FP |
| | EN 300 720 V2.1.1:2017 Ultra-High Frequency (UHF) on-board vessels communications systems and equipment; Harmonised Standard covering the essential requirements of article 3.2 of the Directive 2014/53/EU | SSH EN 300 720 V2.1.1:2017 Sistemet dhe pajisjet e komunikimit me Frekuencë Ultra të Lartë (UHF) në bordin e mjeteve lundruese; Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të Direktivës 2014/53/EU | 2017 | FP |
| | EN 301 025 V2.2.1:2017 VHF radiotelephone equipment for general communications and associated equipment for Class "D" Digital Selective | SSH EN 301 025 V2.2.1:2017 Pajisjet radiotelefoni VHF për komunikime të përgjithshme dhe pajisjet shoqëruese për Klasën "D" të | 2017 | FP |

| | | | | |
|--|--|--|------|----|
| | Calling (DSC); Harmonised Standard covering the essential requirements of articles 3.2 and 3.3(g) of Directive 2014/53/EU | Thirrjes Dixhitale Selektive (DSC); Standard i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 dhe 3.3(g) të Direktivës 2014/53EU | | |
| | EN 301 025 V2.3.1:2021 VHF radiotelephone equipment for general communications and associated equipment for Class "D" Digital Selective Calling (DSC); Harmonised Standard for access to radio spectrum and for features for emergency services | SSH EN 301 025 V2.3.1:2021 Pajisjet radiotelefone VHF për komunikime të përgjithshme dhe pajisjet shoqëruese për Klasën "D" të Thirrjes Dixhitale Selektive (DSC); Standard i harmonizuar për aksesin në spektrin e radios dhe për karakteristikat për shërbimet e emergjencës | 2022 | FP |
| | EN 301 091-2 V1.3.2:2006 Electromagnetic compatibility and Radio spectrum Matters (ERM); Short Range Devices; Road Transport and Traffic Telematics (RTTT); Radar equipment operating in the 76 GHz to 77 GHz range; Part 2: Harmonized EN covering essential requirements of article 3.2 of the R&TTE Directive | SSH EN 301 091-2 V1.3.2:2006 Çështjet e pajtueshmërisë Elektromagnetike dhe të spektrit të Radios (ERM); Pajisje me Rreze të Shkurtër; Telematikat e Trafikut dhe Transportit Rrugor (RTTT); Pajisje radar që punon në frekuencën nga 76 GHz deri në 77 GHz; Pjesa 2: EN i harmonizuar që mbulon kërkesat thelbësore të artikullit 3.2 të direktivës R&TTE | 2017 | FP |
| Ky standard i harmonizuar nuk i adresohet kërkesave lidhur me parametrat e performancës së marrësit dhe nuk jep presumimin e konformitetit për këto parametra. | | | | |
| | EN 301 166 V2.1.1:2016 Land Mobile Service; Radio equipment for analogue and/or digital communication (speech and/or data) and operating on narrow band channels and having an antenna connector; Harmonised Standard covering the essential requirements of | SSH EN 301 166 V2.1.1:2016 Shërbimi Tokësor i Lëvizshëm; Pajisje radio për komunikimin analog dhe/ose dixhital (të të folurit dhe/ose të të dhënave) dhe që punojnë në kanalet me bandë të ngushtë dhe që kanë një bashkues për antenë; Standard i harmonizuar që | 2017 | FP |

| | | | | |
|--|---|--|------|----|
